

VENDIM
Nr. 558, datë 31.7.2019

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITI 2019,
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin “Shpenzime korente”, i shtohet fondi prej 22 494 048 (njëzet e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tetë) lekësh për fillimin e organizimit të edicionit të 41-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, që do të zhvillohet në datat 21–24 tetor 2019, në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama